Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Mbahet Konferenca me Media për Hapjen e Fushatës për Komunikim dhe Sensibilizim për Regjistrimin e Popullsisë (ReKos) 2024

08.03.2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) është mbajtur Konferenca me Media lidhur me hapjen e Fushatës për Komunikim dhe Sensibilizim për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (ReKos 2024).

U.d. i Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së, Avni Kastrati, paraqiti një pasqyrë të gjerë të aspekteve më të rëndësishme të procesit të ReKos 2024.

Në këtë konferencë, ASK-ja elaboroi përgatitjet e deritanishme dhe bazuar në zhvillimet aktuale Kosova/ASK-ja është e gatshëme që ta realizojë Regjistrimin e Popullsisë sipas datës së përcaktuar. Pra, nga 05 Prilli deri më 17 Maj 2024.

Deri më tani, sa janë zhvilluar takime e diskutime të shumta, kjo është faza intensive e komunikimit që është praktikë ndërkombëtare, që fushata kryesore e sensibilizimit dhe komunikimit të fillojë disa javë para Regjistrimit të Popullsisë.

Për më tutje, komunikimi prej këtu e tutje do të vazhdojë në baza ditore përmes mesazheve, artikujve, intervistave e mënyrave të tjera të komunikimit në medie dhe bashkë me mediet.

PLANIFIKO TË ARDHMEN, **REGJISTROHU!**

U.d.i Kryeshefit Ekzekutiv njoftoi se ASK-ja ka implementuar rekomandimet ndërkombëtare për regjistrime që janë të nevojshme në aspektin ndërkombëtar të vlefshmërisë së projektit.

Për ta informuar publikun e gjerë rreth Projektit të Regjistrimit të Popullsisë, me fillimin e regjistrimit në terren, ASK-ja do të organizojë takime të rregullta javore (çdo të hënë) që nga fillimi deri në përmbylljen e Regjistrimit në terren, për t'u njoftuar publiku i gjerë mbi ecurinë e projektit. Ndër të tjera, ai paralajmëroi se do të ketë edhe dy konferenca të tjera për informim, njëra rreth datës 29 mars dhe tjetra me 04 Prill 2024 (një ditë para Regjistrimit në terren).

Tutje, në Konferencë u prezantuan materiale rreth metodës së mbledhjes së të dhënave (metoda CAPI), hartat dixhitale dhe fizike, struktura e organizimit të trajnimeve, përfshirja e institucioneve dhe siguria e procesit, si dhe rekrutimi i stafit (mbikëqyrës dhe regjistrues).